



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**

Në bazë të nenit 15 dhe nenit 33 të Ligjit për planifikimin hapësinor nr. 2003/30, të nenit 11 të Ligjit për ndryshimin e Ligjit për planifikimin hapësinor 2003/14, nr. 03/L - 106 (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 42/2008), të nenit 17 dhe nenit 58 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, nr. 03/L - 040 (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/2008), të nenit 16, pika. 16.1, shkronja **b**, nenit 32, pika 32.1, shkronja **e** dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 – 455, të dt. 31.3.2008, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 23.7.2009, merr

**V E N D I M**  
**PËR FILLIMIN E HARTIMIT TË PLANIT RREGULLUES**  
**“ARBËRIA 1 DHE 2” NË PRISHTINË**

**Neni 1**

Miratohet Vendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues “Arbëria 1 dhe 2” në Prishtinë.

**Neni 2**

Qëllimi i nxjerrjes së Planit rregullues, sipas këtij Vendimi, është rregullimi i hapësirës dhe urbanizimi, sipas destinimeve të planifikuara me Planin strategjik -zhvillimi urban i Prishtinës, i miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës nr. 01-031-1231/1, të dt. 2.7.2004, brenda kufijve të përshkruar në nenin 3 të këtij Vendimi.

**Neni 3**

Me Planin rregullues nga neni 1 i këtij Vendimi, do të përpunohet pjesa e territorit të qytetit të Prishtinës, e emërtuar “Arbëria 1 dhe 2”, e cila përkufizohet: nga ana jugore me rr. “Gjergj Ballshaj”, vazhdon përgjatë rrugës “Toni Bleri”, rr. “Vushtrria”, rr. “Zagrebi” dhe rr. “ Ahmet Krasniqi”, duke u përmblytur me udhëkryqin e rrugës “Gjergj Ballshaj” me sipërfaqe prej 42 ha.

Kufijtë e përshkruar të hapësirës nga par. 1 i këtij neni, janë të paraqitur në pjesën grafike, e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

**Neni 4**

Bartësi i detyrave programore dhe i hartimit të Planit rregullues, sipas këtij Vendimi, do të përcaktohet përmes procedurës së tenderimit. Drejtoritë tjera të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, janë të obliguara që të sigurojnë dhe t’i dërgojnë shënimet e

kërkuara nga Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit, të cilat konsiderohen të jenë të nevojshme për hartimin e Planit rregullues sipas këtij Vendimi.

#### **Neni 5**

Mjetet financiare për hartimin e Planit Rregullues, sipas këtij Vendimi, do të sigurohen nga buxheti i Komunës së Prishtinës.

#### **Neni 6**

Plani Rregullues sipas këtij Vendimi, do të miratohet me vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, si projektplan, në mënyre që ai t'i nënshtrohet diskutimit publik para finalizimit dhe miratimit përfundimtar të tij.

#### **Neni 7**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës. Organet tjera përkatëse kompetente do t'i kryejnë veprimet nga përgjegjësitë e tyre të caktuara me Statut për zbatimin e këtij plani.

#### **Neni 8**

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

### **KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**

**01. nr. 35-1444 më 23.07.2009**

**KRYETARI I KOMUNËS  
Prof. dr. Isa Mustafa**